

VENDIM
Nr. 193, datë 5.4.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 201, DATË 15.3.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË
PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve”, që përmendet në pikën 1, të vendimit nr. 201, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, për politikat e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2019.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi		
1	2	3	4	5	6
			Në funksione të Policisë së Regjimeve të Jashtme, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksione të Policisë së Regjimeve të Brendshme dhe transferim-shoqërimet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksione të policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
Bazë	Nëninspektor	43.000	4.000	8.000	
	Inspektor	46.900	4.000	8.000	
	Kryeinspektor	52.700	4.000	8.000	2.000
I mesëm	Nënkomisar	64.000	4.000	8.000	2.000
	Komisar	69.000	4.000	8.000	2.000
	Kryekomisar	95.000	4.000	8.000	2.000
I lartë	Drejtues	106.700			6.500
	Drejtues I	111.000			15.000
Drejtor i Policisë së Burgjeve	Drejtor i Policisë së Burgjeve	115.000			